



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8658 /2026
Data: 10.09.2026

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tetë -VIII- për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më datë 21.08.2026, me fillim pune në orën 11:00, në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Sevdi Dernjani (Nënkryetar i Komunës), Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Lindita Ballazhi (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), Senad Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Hisni Luri (Drejtor për Arsim), Arbenita Bajramaliu (Drejtoresh për Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Bajrush Laçi (Udhëheqës i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2026.
3. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2027.
4. Propozim për ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
5. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025-2026.
6. Informatë për korrje shirjet.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim rendin e punës. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2026.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani: Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën paraqet një pasqyrë të aktiviteteve , angazhimeve dhe rezultateve të arritura gjatë periudhës Janar -Qershor. Në kuadër të këtij raporti në kuadër të zyrës së kryetarit të komunës janë marrëveshjet të cilat janë të shënuar në raport si dhe të gjitha aktivitete dhe raportimet e drejtorive të tjera.

Menduh Vlashi thekson: ky shabllonë i raportit thjeshtë për mu është bërë bajat dhe me siguri i ka trembëdhjetë apo pesëmbëdhjetë vite që veç ndërrohen datat dhe vitet. Kam kërkuar edhe herën e parë kur është bërë dhe është mirë që drejtorët me ndërruar formatin për shkak se te shumica është i njëjti format që është para pesëmbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë viteve. Me gjithë atë ka disa drejtori që e kanë ndërruar qasjen që ka mundësi edhe të përmirësohet. Për mu personalisht raporti është që tregon se cilat punë janë kryer gjatë gjashtë mujorit dhe nëse ka mundësi krahasimet me gjashtë mujorin e vitit të kaluar. Te drejtoria e arsimit shënon diku takim me kryesuesin e kuvendit të komunës , është realizuar por më intereson me ditë se kur është realizuar dhe çka është biseduar. Te drejtoria e urbanizmit shënon është në procedurë të tenderimit që do të thotë nuk është kryer, është procedurë të shpalljes që do të thotë nuk është kryer pra duhet të tregoni se cilat projekte janë kryer në këtë gjashtë mujorë për shkak se e keni gjashtë mujorin e dytë që me potencuar se është kryer .

Hisni Luri thekson: e paske vërejt që ka ndryshime por edhe përmirësimet mundemi mi bërë por po bien në diskrepancë që po potenconi që po më pëlqen që e kemi shënuar me një faqe pastaj po kërkon se çka është biseduar për shkak se nëse është biseduar shumë nuk del me një faqe. Gabime mund ndoshta të ketë po si të përgjithshme e kemi kompletuar.

Nexhmedin Daci thekson: projektet kapitale janë të rëndësishme në çdo komunë jo vetëm për neve dhe listën e projekteve kapitale duhet me paraqitur se ku kanë mbetur projektet , në mënyrë që me paraqitur pak a shumë se ku jemi , ky ka qenë qëllimi që me ditur se në çfarë faze është një projekt kapital.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026 QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

3. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2027.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson: përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Menduh Vlasi thekson: përveç KPF-së dhe në mbledhje të kuvendit të komunës që jepen propozimet dhe përcillen për debat dhe kur të kthehet prej debatit kuvendi nuk është mirë me i ndryshuar gjërat sepse çdo ndryshim në kuvendin e dytë duhet me shkuar përsëri në debat me i njoftuar qytetarët.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU SHYRTIMI I RREGULLORES PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2027 QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

4. Propozim për ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson: është diskutuar çështja e komisionit që ka qenë prej tre anëtarë dhe është bërë në pesë anëtarë por kjo ka qenë kërkesë e aduditorëve dhe kjo ka qenë arsyeja që kemi propozuar për me u ndryshuar. Shumë komuna e kanë por e kanë përfshirë edhe shoqërinë civile.

Menduh Vlasi thekson: unë e kam studiuar mirë kur i keni bërë ndryshimet dhe më vjen keq që nuk keni qenë kur e kam ngritur këtë çështje nëpër takime. Është e vërtetë që ju keni kërkuar me ndryshuar vetëm komisionin që unë pajtohem që duhet të i përshtatet ligjit por unë kam reaguar te ndryshimi që është bërë pa transparencë . E kam marr procesverbalin e debatit publik që aty i ke potencuar të njëjtat fjalë që duhet ta ndryshojmë komisionin dhe nuk keni potencuar që duhet të ja bartim kompetencat kryetarit të komunës për caktimin e kriterëve dhe shumën e bursave . E kam marr materialin dhe procesverbalin e kuvendit të komunës kur është miratuar ky plotësim ndryshim. Në propozim keni potencuar që të kryetari i komunës i bartet kompetenca por në kuvend nuk e keni theksuar dhe unë vazhdimisht kam reaguar se është shkelje ligjore sepse buxheti është kompetencë ekskluzive e kuvendit të komunës dhe nuk mund të barten çështjet buxhetore kompetencë kryetarit e ju ja keni bartur . Unë kam kërkuar që me ju kthyer kuvendit të komunës caktimi i shumës dhe kriteret për arsye se nuk është njëjtë sikur një person i cakton kriteret dhe fakultet prioritarë por ndryshe është kuvendi , andaj kam kërkuar me ju kthyer dhe po besojë që duhet të i kthehen sepse është shkelje ligjore. Pasi ka hyrë në procedurë kërkoj që te neni shtatë te komisioni që ka kaluar në pesë anëtarë por do të ishte mirë që me u shtuar edhe një pikë shtatë pikë shtatë që anëtarët e komisioneve të cilët i cakton kryetari i komunës hartojnë raport për kryetarin e komunës dhe kuvendin e komunës sepse në bazë të kësaj nuk kanë obligim me na raportuar neve , a realisht për çështje buxhetore duhet të raportohet te kuvendi i komunës që realisht kuvendi me ditur se ku kanë shkuar ato mjete financiare.

Bajrush Laçi thekson: shkelje ligjore nuk ka pasur për shkak se është çështje e kuvendit të komunës që vendosë . kuvendi i komunës ka të drejtë me i dhënë kompetencë kryetarit por ka të drejtë me ja marr kompetencën.

Menduh Vlasi thekson: është shkelje ligjore sepse është bartur kompetencë e buxhetit të komunës te kryetari i komunë që nuk ka të drejtë.

Kryesuesi thekson: këtu duhet të ndryshohet neni katërmëdhjetë pikë dy ku vendosë vetëm kryetari i komunës , për numrin e bursave duhet kuvendi i komunës me vendosur . Vetëm këtë kemi me ndryshuar dhe për çdo vit fiskal kemi me marr vendim sa bursa me i ndarë pra në bashkëpunim me kryetarin e komunës.

Menduh Vlasi thekson: kur kemi filluar si komunë me ndarë subvencione vetëm për bursa kemi ndarë dhe nuk kemi ndarë as për traktor , mirëpo duhet të shënohet qartë aty jo vetëm për bursa shuma e subvencioneve të bujqësisë dhe dedikimi se për çka , apo te zhvillimi ekonomik, te sporti dhe kultura. Normal që drejtoria e harton propozim vendimin pra bënë propozim vendim për ndarjen e traktorëve dhe vlera është kjo dhe kuvendi e miraton dhe çdo gjë në rregull shkon . Propozim vendim për ndarje e bursave pra katër dhjetë bursa nga pesëqind euro . Edhe te sporti edhe te kultura është mirë që një propozim vendim me ja parashtruar paraprakisht kuvendit të komunës që drejtoria i planifikon këto mjete për klubet sportive sepse ndahen tridhjetë mijë euro për sport dhe kulturë ashtu si ju teket por është mirë që me ju drejtuar kuvendit me propozim vendim dhe kuvendi e miraton.

Hisni Luri thekson: këtë ndryshim e kemi përcjell për në Ministri të Pushtetit Lokal por po e lexojë atë që e ka kthyer Ministria e Pushtetit lokal që potencon që si përfundim të aktit administrative të komunës së Hanit të Elezit në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbetet në dispozicione të komunës së Hanit të Elezit , Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për çdo sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim. Pse është bërë kjo që kryetari i komunës me mor vendim, ideja ka qenë që me kanë më e lehtë qasja, për ndryshe shuma prej katër dhjet mijë euro të ndara prej buxhetit ju e miratoni sepse ju e miratoni buxhetit. Dhe kur diskutohet shuma prej katër dhjet mijë euro nuk i kemi vetëm bursat por e kemi mësimdhënësin më të mirë, nxënësin më të mirë, botimet e librave dhe kemi edhe shumë tjera që prej këtij kodi është menduar me mor mjete nëse i kryej obligimet me bursa. Kur është diskutuar rregullorja në debat publik ka pasur pretendime që me pasur treqind euro që me shtuar numrin e studentëve, dikush ka potencuar që me pasur një mijë euro dhe me pasur kualitet. Por unë jam i pajtimit që vlersone si të doni edhe planifikimet dhe komisionet rregulloni sepse mu më bëni një nderë që mos me u marr me këtë pjesë hiq, jo për me ikur përgjegjësisë por nëse mendoni që transparenca është më e mirë kështu vlersone.

Menduh Vlasi thekson: unë e kam përgatitur dosjen do ti përcjelli te hetuesit dhe ata e vendosin po ky ndryshim është bërë jo në mënyrë transparente dhe ata vendosin se a është bërë shkelje se në debat publik keni potencuar se nuk ka ndonjë ndryshim të madh por do të ndryshohet komisioni për shkak të ligjit dhe nuk e dinë qytetarët se ju është bartur kompetenca kryetarit të komunës. Ju si drejtorë kur e keni marr fjalën në kuvend keni potencuar që komisioni duhet të ndryshohet dhe aspak nuk e keni përmendur që do ti a bartim kompetencat kryetarit të komunës por me propozim vendim në letër saktë e keni përmendur aty dhe kryesuesi i kuvendit e ka nënshkruar pra do me thënë në mënyrë jo transparente ju ka bartur kjo kompetencë dhe kjo kompetencë nuk i bartet dhe duhet të i kthehet kuvendit të komunës .

Hisni Luri thekson: një sekuencë të një filmit regjisorit nuk mundesh me ja treguar dhe ty po e kapë atë pjesën që unë ndoshta kam harruar me potencuar para tyre apo në procesverbal , për ndryshe kjo ka qenë e njohur dhe ne nuk e kemi bërë sot për nesër por kjo ka kaluar me muaj të tëra. Është bërë mirë që është rritur numri i studentëve që janë përfitues të bursave , janë përfshirë edhe studentëve të tjera.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIMI PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

5. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025-2026.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson: përveq materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Menduh Vlashi thekson: në faqen katër shënon se numri i nxënësve nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë në nivel komunal gjithsejtë janë 251 nxënës , a në tabelarë na dalin ndryshe 521 , pastaj në tabelarë dalin 531 dhjetë nxënës diferencë . Unë nuk e di a është mirë me shkrim a në tabelarë . Më poshtë e ki në të njëjtën faqe që potencon që krahasimi i nxënësve në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollorë në edukimin para fillorë është zvogëluar për katër nxënës a në tabelarë e ki për katërmëdhjetë nxënës dhe për mu ai i cili nuk din mi mbledhur dhe me i zbritur numrat realisht është i padijshëm për një lëmi e jo për krejt . Ka edhe shifra të tjera që nuk përputhen diku shënon që njëzet e nëntë nxënës janë më pak. Unë e di se pse vijnë këto por ty së paku tregoju publikisht që kur ta kam dorëzuar mandatin kam potencuar se për çka të kesh nevojë thirrëm se ka me të ndihmuar. Kontrollroje informatën se keni gabime plotë, për shkak se kjo informatë mbetet dokument se këto gabime janë ose prej neglizhencës ose ata të cilët ja kanë përcjell drejtorit nuk dinë me mbledhur dhe me zbritur por drejtori nuk e ka kontrolluar se tjetër kush ja bënë.

Sevdi Dernjani thekson: unë e vlerësoj shumë kur bënë kritika konstruktive të llojit që je duke i bërë te drejtorja e arsimit që ka mos përputhje prej dhjetë në katërmëdhjetë dhe për këta është edhe komiteti për politikë e financa që raportet me u publikuar si të kompletuara. Për këtë jam shumë falënderues që e bënë këtë kritikë por p.sh me u quajtur të paditur e që mundesh me përdorë një term tjetër dhe me potencuar që mos i neglizho dokumentet kur ti dërgojnë prej njësisë kërkuese dhe me vazhduar në komitet për politikë e financa me dokumentacione të kompletuar.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI SUKSESIN E ARRITUR TË NXËNËSVE NË SHFMU DHE SHML NË FUND TË GJYSMËVJETORIT TË DYTË TË VITIT SHKOLLOR 2025-2026 QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

6. Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson: materialin e kam përcjell me kohë dhe përveq materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Menduh Vlashi thekson: kanë qenë katër dhjetë e gjashtë hektarë e tash katër dhjetë që do të thotë ndoshta janë mbjell më pak dhe është mirë me shkrim me najë sqaruar.

Abduraman Bushi thekson: Ka të bëjë me rendimentin që në këtë vit ka qenë më pak se në vitin e kaluar.

Kryesuesi thekson: a ka kombaj ndonjë person në Han të Elezit për shkak se po ankohen qytetarët se nuk kemi kombaj për me korr grurin dhe nëse janë mundësit është mirë me subvencionuar dikendë me kombaj që me ju përgjigjur çdo kujt që e mbjellë tokën

Abduraman Bushi thekson: ka kombaj z.Sadik Huneli por një problem ka qenë pak në fillim se kemi pas një fermer që ka mbjell grurë te Ura e Seqishtës dhe gruri pjekët më herët dhe ai nuk ka ardhur me korrë pa filluar krejt sezona dhe në momentin që ka filluar puna ka shkuar krejt marr . Sa i përket kombajit e kemi diskutuar edhe me Labin se është problem me subvencionuar dikend me kombaj sepse mund të ja japim sot dhe ai e shet ndoshta nesër pra nuk ka persona të përgjegjshëm . Mbjellja e grurit dhe korja janë private dhe kombanjeri me fermerin merren veshë për korrjen e grurit.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA PËR KORRJE SHIRJET QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:37.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta

